



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr.1038/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit Habib Makolli nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Drenasit, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

## **V E N D I M**

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.1038/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit, Habib Makolli nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Drenas me të cilën ka kërkuar rinumërimin e fletëvotimeve në vendvotimin 0322E/02D.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit Habib Makolli nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Drenas, në të cilën pretendon se në vendvotimin 0322E/02D, i mungojnë votat e konfirmuara nga votuesit të cilët i kanë premtuar që e kanë votuar, dhe në atë vendvotim nuk figuron as një votë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se nga kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit Habib Makolli nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Drenasit është paraqitur apeli me të cilin ka kërkuar rinumërimin e fletëvotimeve në vendvotimin 0322E/02D.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tije, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mungesën e votave, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesen, në rastin konkret, paneli nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për

kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë vetëm supozime, për faktin se pretendimet e votuesve nuk i ka mbështetur në dëshmi të qarta dhe bindëse.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Anr.1038/2021 më datën 06.11.2021**



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.